



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16.2.2024

Nr: 19

Ora: 12:00

VENDIM  
PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË TROPOJË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË  
FITOJMË”, Z. HAMIT IBRAHIM BERISHA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 5811/2 prot., datë 3.1.2024, Këshilli i Bashkisë Tropojë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Dritan Fadil Gjongecaj, propozuar nga subjekti politik Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për Këshillin e Bashkisë Tropojë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 5, z. Hamit Ibrahim Berisha.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KU-BF-10121\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Hamit Ibrahim Berisha, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Data: 16.2.2024 Nr: 19  
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Hamit Ibrahim Berisha”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 200 prot., datë 23.1.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 201 prot., datë 23.1.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Hamit Ibrahim Berisha.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 898/1 prot., datë 30.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Hamit Ibrahim Berisha, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1121/1 prot., datë 26.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Hamit Ibrahim Berisha, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Hamit Ibrahim Berisha, në Këshillin e Bashkisë Tropojë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

### **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Hamit Ibrahim Berisha.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**